

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarene vetme gjykuese Fatime Dërmaku, me zyrtaren ligjor Edona Grajçevci, në çështjen penale, kundër të pandehurit Sh.B., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.6733/17, të dt.06.12.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt.06.09.2018, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.6733/17, të dt.06.12.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

I pandehuri: Sh.B., nga i ati Sh., i lindur me datë ..., me vendbanim në rrugën "S.M." nr.... në P., ku edhe jeton, me nr. personal ..., shqiptar, shtetasee Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

S e p s e: Me datë 31.10.2017, rreth orës 09:05, në rrugën rajonale Dardhisht-Obiliq, përball kompanisë "E." O., i pandehuri Sh.B., derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës "Mercedes Benz", ngjyrë e bardh, me targa të regjistrimit ..., nga pakujdesia, duke menduar lehtë se nuk do të rrezikoj komunikacionin, nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit duke rrezikuar jetën e njerzëve dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit mbi bazat e sigurisë së trafikut, /Nr.05/L-88/, i cili duke mos ju kushtuar kujdes pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, ka marr veprimin për tu kyqur në rrugë kryesore nga parkingu i firmës "E." në rrugë pa i penguar dhe pa i rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në trafik dhe me pjesën e përparme të anës së majtë, e godet automjetin e markës "VW Passat" ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., në pjesën e parë të anës së djathtë, të cilin automjet e drejtonte i dëmtuari I.R., i cili ishte duke lëvizur në rrugën me përparsi kalimi, me çrast lëndime të lehta trupore pëson ngasësi i automjetit "VW Passat", I.R. dhe shkaktohet aksident komunikacioni me dëme materiale në automjete,

me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dënuari dënimin e shqiptuar me gjobë mund ta paguajë me dy këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet)€ të gjobës.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **40.88€** dhe ekspertizën mjekoligjore në shumë prej **20 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumë prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: I.R., me vendbanim në fshatin D., në O., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.6733/17, të dt.06.12.2017 e ka akuzuar Sh.B., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjyqësore, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjituranë shkresat e lëndës, dhe atë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugorë ing.A.G. e dt.21.11.2017 ekspertiza mjeko-ligjore e ekspertit Dr.D.H. e dt.22.11.2017, dhe dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se i pandehuri Sh.B., është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par.1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.5627/17

Më datë 06.09.2018

Zyrtarja Ligjore
Edona Grajçevci

Gjyqtarja,
Fatime Dërmaku

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.